



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 517 Akti

Nr. 502 Vendimi
Tiranë, më 17.1.2022

V E N D I M

Trupi gjykues nr. 1 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Valbona Sanxhaktari	Relatore
Lulzim Hamitaj	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në datën 13.1.2022, në orën 10:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Rudina Palloj**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, e pranishme në seancën dëgjimore.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet “A”, “Ç”, “D”, “DH”, “E”, të Aneksit të Kushtetutës;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Valbona Sanxhaktari, dëgjoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore, analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Rudina Palloj është subjekt i rivlerësimit për shkak të pozicionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat. Bazuar në pikën 4 të nenit 4 dhe në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në vijim, ka hedhur shortin në datën 15.6.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i sipërcituar.
2. Me vendimin e trupit gjykues, datë 18.6.2020, është vendosur kryesuese znj. Genta Tafa (Bungo) dhe është deklaruar lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.
3. Subjekti i rivlerësimit është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues që do të kryente procesin e rivlerësimit, e cila ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me pjesëtarët e trupit gjykues.
4. Nga relatori janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Gjatë procesit të rivlerësimit është komunikuar me subjektin e rivlerësimit nëpërmjet adresës elektronike.
5. Në datën 6.12.2021, trupi gjykues vendosi: (a) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit Rudina Palloj, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: kriterin e vlerësimit të pasurisë, kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional; (b) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit dhe ta ftojë për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (c) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta dhe të paraqesë parashtrimet e saj.
6. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj, fakt të cilin e konfirmoi edhe në seancën dëgjimore, si dhe paraqiti shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit të Komisionit.
7. Trupi gjykues, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, ftoi subjektin e rivlerësimit Rudina Palloj në seancë dëgjimore në datën 13.1.2022, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

8. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 13.1.2022, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin.
9. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht, ku paraqiti shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.
10. Trupi gjykues përfundoi seancën dëgjimore dhe, për rrjedhojë, edhe procesin e rivlerësimit për znj. Rudina Palloj në seancën e datës 17.1.2022, në të cilën subjekti ishte e pranishme.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

11. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e

nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

12. Komisioni, bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga subjekti pranë këtij institucioni në “deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- c) informacionin e përditësuar lidhur me subjektin e rivlerësimit nga institucionet ligjzbatuese;
- ç) raportin e dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, së bashku me materialin shoqërues;
- d) dokumentet shkresore nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- dh) deklaratimet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht;
- ë) denoncimet nga publiku.

A. VLERËSIMI I PASURISË

13. Subjekti i deklaramit ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, së bashku me dokumentacionin provues. Kjo deklaratë, në bazë të nenit 33¹ të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtrua hetimit administrativ nga ky institucion.

14. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 86/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

15. Deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Rudina Palloj iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, e cila edhe pas verifikimit administrativ të kryer nga Komisioni, ka rezultuar si vijon:

1. Pasuria tokë arë me sip. 30.354 m², nga të cilat 300 m² truall, përfituar me AMTP datë 10.12.1993, nga Komisioni i Ndarjes së Tokës së fshatit ***, Devoll. Në këtë pasuri, si anëtare e familjes bujqësore, subjekti shprehet se ka të drejtë bashkëpronësie mbi sip. 7088 m² tokë, e ndodhur në fshatin ***, Devoll, e regjistruar pjesërisht vetëm për sip. 560 m² pemëtore, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, me sip. 605 m² tokë, nga e cila truall 300 m², ndërtesë 96 m², z. k. ***. Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: pasuri e përfituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”. Pjesa takuese: bashkëpronësi e familjes bujqësore, e pandarë.

1.1 Nga informacioni i vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit rezultojnë se këto pasuri figurojnë në regjistrat manualë. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit datë 21.6.2021,

¹Procedura e vlerësimit të pasurisë 1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaratimet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, si dhe Kodin e Procedurave Administrative.

sqaron² se: “Nga të gjitha pasuritë e përcaktuara në këtë AMTP familja ime është pajisur me certifikatë pronësie vetëm për dy pasuri, të cilat i kam specifikuar në deklaratimin fillestar dhe në deklaratën Vetting. Sa i përket arsyes pse pasuritë e përfituara në AMPT janë pjesërisht të regjistruara, sipas informacionit që kam marrë nga ASHK Devoll në datën 23.6.2021 kjo ka ndodhur për shkak se rezultojnë diferenca në sipërfaqe nga matjet faktike për një pjesë të parcelave, ndërkohë që për një pjesë tjetër të tyre parcelat nuk janë të azhornuara. Unë, motra dhe vëllai im nuk kemi kërkuar veçimin e pjesës takuese në momentin e shkëputjes nga trangu familjar. Kjo pasuri ka qenë dhe është edhe aktualisht në bashkëpronësi në tërësi të familjes bujqësore si për pjesët për të cilat im atë është pajisur me certifikatë pronësie ashtu edhe për pjesën tjetër për të cilën nuk është pajisur për shkak të problematikës së shpjeguar në informacionin e vënë në dispozicion nga ASHK Devoll”.

1.2 Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur, ndër të tjera, pyetësorit dokumentet: (a) informacionin datë 23.6.2021, nga ASHK-ja Zyra Vendore Devoll; (b) Certifikatën për vërtetim Pronësie për pasurinë nr. ***; (c) Certifikatën për vërtetim Pronësie për pasurinë nr. ***; (ç) vendimin nr. ***, datë 19.10.1998, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

1.3 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm rezulton se:

a) Nëpërmjet informacionit³ datë 23.6.2021, të përcjellë nga ASHK Devoll, konfirmohet se në bazë të AMTP-së nga regjistri fillestar rezultojnë të regjistruara 11 pasuri në emër të shtetasit M. P., por certifikatat për vërtetim pronësie nuk janë lëshuar për këto pasuri (me përjashtim të pasurisë nr. ***), pasi nga regjistrimi fillestar rezulton e regjistruar sipërfaqe më tepër se ajo e dhënë në pronësi. Kjo problematikë është në proces trajtimi nga ana e Zyrës Vendore të ASHK-së Devoll.

b) Shtetasi M. P., sipas Certifikatës së Pronësisë datë 6.12.2001, është pronar i pasurisë pemëtoze me sip. 560 m², nr. pasurie *** dhe vendndodhje në fshatin ***, Devoll.

c) Shtetasi M. P., sipas Certifikatës së Pronësisë datë 6.12.2001, është pronar i pasurisë vresht + truall me sip. totale 605 m², nr. pasurie *** dhe vendndodhje në fshatin ***, Devoll. Në kartelën e pasurisë datë 18.8.2000 përcaktohet se sip. prej 605 m² përbëhet nga trualli prej 300 m² dhe ndërtesë prej 96 m².

ç) Pronësia mbi objektin e banimit i është njohur shtetasit M. P. me vendimin nr. ***, datë 19.10.1998, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. ASHK-ja Devoll, në informacionin e sipërcituar, ka konfirmuar se kjo pasuri është regjistruar në zbatim të VKM-së nr. 432, datë 14.8.1995, “Për procedurën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonat urbane të fshatit”, i ndryshuar (aktualisht i shfuqizuar).

1.4 Komisioni nuk ka konstatuar problematika për këtë pasuri.

2. Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, blerë me Kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.10.2016, kundrejt shumës 479.500 (katërqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekë (3.500 euro). Burimi i krijimit sipas deklaratës Vetting: të ardhurat nga kursimet ndër vite nga paga si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat; si dhe pagesat nga puna si pedagoge e jashtme në universitetin jopublik “***”.

2.1 DPSHTRR-ja konfirmon⁴ për Komisionin se automjeti me targa *** është i regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, duke përcjellë edhe dosjen e tij.

2.2 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DPSHTRR-së rezulton se:

²Shihni përgjigjen nr. 1 në pyetësorin e datës 21.6.2021.

³Shihni dokumentacionin bashkëlidhur pyetësorit datë 21.6.2021.

⁴Shihni shkresën nr. *** prot., datë 15.9.2021.

a) Automjeti tip “Mercedes-Benz”, viti i prodhimit 2002, rezulton se është blerë nga shtetasi L. M. në Belgjikë prej shtetases V. A. sipas Kontratës datë 5.9.2016, të nënshkruar mes dy palëve, me çmimin e blerjes 500 (pesëqind) euro. Në datën 21.9.2016 ky automjet është zhdoganuar në Doganën Durrës nga shtetasi L. M. dhe detyrimi doganor i paguar nga ky shtetas është në vlerën 73.247 (shtatëdhjetë e tre mijë e dyqind e dyzet e shtatë) lekë.

b) Në vijim është nënshkruar Kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.10.2016, me palë shitëse shtetasin L. M. dhe palë blerëse subjektin e rivlerësimit në vlerën 479.500 (katërqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekë (3.500 euro), e cila është paguar jashtë zyrës noteriale para lidhjes së kontratës.

2.3 Komisioni kreu analizën financiare nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka të ardhura të ligjshme për blerjen e automjetit në vitin 2016, duke mos konstatuar problematika për këtë pasuri.

3. Apartament në përdorim, në rrugën “****”, pallati “****”, shkalla ***, apartamenti ***, Tiranë, në të cilin subjekti jeton që prej janarit të vitit 2016, në pronësi të shtetasit G. Zh., kundrejt pagesës së qirasë mujore prej 300.000 (treqind mijë) lekësh/vit ose 25.000 (njëzet e pesë mijë) lekë/muaj.

3.1 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me adresën e vendbanimit, në përgjigjet e pyetësorit standard, sqaron⁵ se: *“Në periudhën shkurt 2016 - qershor 2018 kam banuar në apartament me qira në rrugën ‘****’, pallati ‘****’, shkalla ***, apartamenti ***, Tiranë, banesë me qira mujore 25.000 lekë në pronësi të shtetasit G. Zh.. Kjo marrëdhënie ka qenë me kontratë jo formale për shkak se pronari jeton në SHBA. Për të gjithë periudhën e qëndrimit pagesa është shlyer në dy momente kohore: (1) për vitin 2016 është bërë në fund të tij, duke ia dorëzuar një personi të dërguar prej pronarit; (2) për periudhën janar 2017 - qershor 2018 pagesa është bërë në nëntor 2018 në llogarinë bankare të qiradhënësit G. Zh.”.*

3.2 Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur, ndër të tjera, pyetësorit standard edhe Deklaratën Noteriale të lëshuar nga shtetasi G. Zh. në datën 3.8.2020 para noterit publik K. O. J., i cili deklaron se marrëdhënia kontraktore nuk ka qenë e formalizuar me shkrim për shkak të qëndrimit të tij jashtë shtetit: *“Marrëdhënia e qirasë ka vijuar prej muajit janar ose shkurt të vitit 2016 deri në muajin korrik 2018. Pagesa e parë është kryer prej saj në fund të vitit 2016 duke u paguar vlera totale e qirasë nga momenti i krijimit të kësaj marrëdhënieje. Shuma i është dorëzuar një personi të afërm të dërguar prej meje. Pagesa e dytë është bërë në vitin 2018. Pagesa e kryer në këtë vit në vlerën totale 450.000 lekë ka përfshirë pagesën e qirasë për vitin 2017 dhe gjysmë e parë të vitit 2018, pasi në korrik të këtij viti qiradhënësja ka liruar dhe dorëzuar banesën time sepse ishte zhvendosur në banesën e saj”.*

3.3 Banesa e zotëruar me qira, sipas dokumentacionit⁶ të disponuar nga subjekti i rivlerësimit, figuron se është blerë nga shtetasi G. Zh. me Kontratë Porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.8.2013, me palë sipërmarrëse shoqërinë “****” sh.p.k., për vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro.

3.4 Nga verifikimi i kryer në sistemin TIMS për shtetasin G. Zh. rezulton se përputhen të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

3.5 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me burimin e të ardhurave për pagesën e qirasë, deklaron në pyetësorin e datës 21.6.2021 se shpenzimet e qirasë të vitit 2016 janë mbuluar nga të ardhurat vetjake dhe pagesa është kryer *cash*. Nga analiza rezulton se subjekti i rivlerësimit ka mundësi financiare për kryerjen e pagesave. Sa i përket pagesës së qirasë për periudhën 2017 - korrik

⁵Shihni përgjigjen nr. 1 në pyetësorin e datës 31.8.2020.

⁶Shihni dokumentacionin bashkëlidhur pyetësorit datë 17.9.2021.

2018, subjekti i rivlerësimit deklaroi në pyetësorin e datës 21.6.2021 se burimi i të ardhurave ka qenë nga kredia e marrë në “Raiffeisen Bank”, në datën 27.8.2018. Sipas veprimeve bankare rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka derdhur në datën 21.11.2018 në llogarinë bankare, në emër të shtetasit G. Zh., vlerën 450.000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

3.6 Komisioni ka pyetur Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat lidhur me çështje të trajtuara me shtetasin G. Zh., për raste të mundshme të konfliktit të interesit dhe nga përgjigjet⁷ nuk kanë rezultuar të dhëna.

3.7 Komisioni nuk ka konstatuar problematika për këtë pasuri.

4. Llogari kursimi në formën e fondit të investimit në “Raiffeisen Bank”, e hapur më 14.2.2013, me gjendje aktuale të llogarisë në kohën e plotësimit të deklaratës në vlerën 60.500 (gjashtëdhjetë mijë e pesëqind) lekë.

4.1 Subjekti i rivlerësimit deklaroi në DPV-në e vitit 2013 kursime të depozituara në formën e fondit të investimit në vlerën 323.500 (treqind e njëzet e tre mijë e pesëqind) lekë në “Raiffeisen Bank” dhe ka deklaruar shtesat dhe pakësimet e fondit në deklaratimet periodike vjetore të viteve vijuese.

4.2 Subjekti i rivlerësimit, nga analiza e llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank”, rezultoi se ka depozituar *cash* shumë prej 230.000 (dyqind e tridhjetë mijë) lekësh, në datën 13.2.2013, në llogarinë e saj të pagës, të cilat i ka investuar për blerje kuotash në fondin e investimit Raiffeisen Prestigj. Balanca e fondit monetar të investimit është shtuar dhe pakësuar gjatë muajve të vitit 2013 derisa në datën 8.11.2013, shuma finale prej 300.000 (treqind mijë) lekësh është investuar në fond investimi duke mbajtur këtë balancë deri në fund të vitit. Kjo balancë ka ndryshuar, ndër vite, duke u shtuar dhe pakësuar në varësi të përdorimit të tij.

4.3 Nga analiza financiare duket se subjekti i rivlerësimit ka mundësi financiare me të ardhurat nga paga me një balancë minimaliste negative për krijimin fillestar të fondit të investimit në vlerën 230.000 (dyqind e tridhjetë mijë) lekë, në datën 13.2.2013, ka mundësi financiare për shtimin e këtij fondi të investimit deri në shumë 300.000 (treqind mijë) lekë të reflektuar në fund të vitit, si dhe ka mundësi financiare në vitet vijuese për krijimin e shtesave përkatëse (referojuni analizës së plotë të periudhës *Vetting*).

4.4 Në përfundim konstatohet se subjekti i rivlerësimit rezultoi me të ardhura të ligjshme për krijimin fillestar të kësaj pasurie në vitin 2013, duke mos rezultuar problematika lidhur me këtë pasuri të subjektit.

GJETJE TË TJERA

5. Gjendje *cash* në vlerën 830.000 (tetëqind e tridhjetë mijë) lekë, jashtë sistemit bankar, e deklaruar si kursime në deklaratën para fillimit të detyrës së vitit 2011.

5.1 Në deklaratën periodike vjetore para fillimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit deklaroi si burim për krijimin e gjendjes *cash* të ardhurat: nga puna si juriste në Bashkinë Korçë për periudhën korrik 2008 - shtator 2009; nga puna si pedagoge e jashtme në universitetin “***”, dega Korçë, për periudhën tetor 2008 - mars 2009; si dhe nga bursa e përfituar nga Shkolla e Magjistraturës për periudhën tetor 2009 - dhjetor 2010.

5.2 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar ndryshime të gjendjes *cash* në deklaratimet periodike vjetore dhe as në deklaratën *Vetting*.

⁷Shihni shkresat nr. *** prot., datë 30.9.2021 dhe nr. *** prot., datë 4.10.2021.

5.3 Komisioni ka kërkuar shpjegime nga subjekti i rivlerësimit lidhur me kursimet *cash* të deklaruara dhe, në përgjigje të pyetësorit datë 17.9.2021, sqaron⁸ se: *“Kursimet administroheshin nga prindërit me të cilët kam jetuar në mënyrë të vazhdueshme deri në vitin 2014 kur jam zhvendosur në Tiranë. Në momentin që jam transferuar në Tiranë nuk kam marrë kursimet me vete për shkak të jetesës vetëm, si dhe për shkak të mënyrës se si është zhvilluar marrëdhënia ime me prindërit e mi si në kohën që kam jetuar me ta edhe pas këtij momenti. Kjo shumë është administruar prej prindërve të mi dhe është shpenzuar për nevoja të familjes ndër vite. Në momentin që kam plotësuar DV unë nuk e kam pasur këtë shumë”*.

5.4 Sipas deklarimeve të subjektit, shuma *cash* është shpenzuar për nevoja të familjes, ndër vite, dhe deri në tetor të vitit 2009 figuron se ka jetuar në shtëpinë e prindërve dhe nga nëntori i vitit 2009 ka jetuar në Tiranë me qira kur ka filluar Shkollën e Magjistraturës.

5.5 Komisioni ka përgatitur një analizën financiare kumulative për periudhën gusht 2008 – tetor 2011, nga e cila rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për të krijuar këtë shumë deri në tetor të vitit 2011.

5.6 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratimet periodike vjetore në vijim dhe as në deklaratën *Vetting* lidhur me shumën e gjendjes *cash* të deklaruar në vitin 2011 prej saj.

5.7 Subjekti i rivlerësimit, në prapësime, ka shpjeguar edhe një herë për Komisionin se: *“Problematika e konstatuar në lidhje me mosdeklarimin e ndryshimeve të saj ndër vite, është një pakujdesi e paqëllimshme në lidhje me mënyrën e deklarimit të gjendjes *cash* në fund të çdo viti, e cila ka ardhur si pasojë e: (a) mënyrës se si e kam konceptuar deklarimin periodik vjetor, duke mos pasur të qarta konceptet lidhur me pakësimin apo shtimin e likuiditetit ose gjendjes *cash* ndër vite; (b) mungesës së kujdesit të duhur për të bërë në fund të çdo viti një bilanc vjetor, para plotësimit të deklaratës; dhe (c) faktit që kjo shumë është administruar nga prindërit e mi me të cilët kam jetuar për disa vite dhe është shpenzuar tërësisht për nevoja të përditshme të familjes në tërësi, pjesë e së cilës kam qenë dhe unë për disa vite”*.

5.8 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi në deklaratën *Vetting* i gjendjes *cash*, i analizuar në këndvështrimin e të gjitha deklarimeve periodike vjetore dhe asaj për herë të parë, sjell një pasaktësi në deklaratë dhe se subjekti duhet të ishte shprehur për pakësimin e gjendjes *cash* në zbatim të detyrimeve që vijnë nga germa “d”, e pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003. Por trupi gjykues vlerëson se pavarësisht këtij arsytimi, për sa kohë që këto pasaktësi nuk shoqërohen me mungesa të burimeve të ligjshme për të krijuar pasurinë *cash* të deklaruar fillimisht, si dhe problematika në krijimin e pasurive të tjera në vijim apo mungesë të burimeve financiare të të ardhurave ndër vite, apo pasuri të deklaruara vit pas viti, nuk mund të kualifikohen si asnjë prej situatave të parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016 dhe të përbëjnë, për pasojë, një shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

6. Vendbanime të deklaruara në deklaratimet periodike vjetore nga subjekti i rivlerësimit

6.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë në DPV-në e vitit 2012 si adresë vendbanimi në qytetin e Tiranës rrugën “***”. Kjo adresë është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si vendbanimi zyrtar në DPV-në e vitit 2013 dhe shpenzimet vjetore të qirasë në vlerën 300.000 (treqind mijë) lekë.

6.2 Nga hetimi i kryer nga Komisioni rezulton se subjekti i rivlerësimit, gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës në Berat, ka disponuar një ambient me qira. Subjekti shpjegon në pyetësorin standard⁹ se ka qëndruar në Berat që prej fillimit të ushtrimit të detyrës, pra, vitit

⁸Shihni përgjigjen nr. 1 në pyetësorin e datës 17.9.2021.

⁹Shihni përgjigjen nr. 1 në pyetësorin datë 31.8.2020.

2014, në një banesë në pronësi të shtetasit H. F., por të cilën e deklaroi të shfrytëzuar për periudhën shtator 2017 – korrik 2019, me qira 7.000 (shtatë mijë) lekë/muaj dhe pagesa është bërë një herë në disa muaj, duke vënë në dispozicion Kontratën e Qirasë nr. *** rep., nr. *** kol., të lidhur në datën 9.4.2018, me palë qiradhënëse shtetasin H. F., pa afat kohor.

6.3 Komisioni ka kryer hetime për raste të mundshme të konfliktit të interesit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat dhe, nga përgjigjet¹⁰, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka gjykuar ndonjë çështje me palë ndërgjyqëse qiradhënësit.

6.4 Komisioni ka përfshirë në analizë financiare shpenzimet e qirasë përkatësisht, sipas rasteve, duke mos konstatuar problematika për këto pasuri apo të dhëna dhe *indicie* për hetime të mëtejshme.

7. Apartament banimi me sip. 61.30 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, blerë me Kontratën e Shitblerjes me Rezervë të Pronës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.6.2019, me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k., në vlerën 28.120 (njëzet e tetë mijë e njëqind e njëzet) euro.

7.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në pyetësin standard¹¹ blerjen e kësaj pasurie, e cila është kontraktuar fillimisht me Kontratën e Porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.12.2017, në vlerën 27.320 (njëzet e shtatë mijë e treqind e njëzet) euro. Çmimi i apartamentit është likuiduar me dy këste, ku konkretisht pagesa e parë prej 14.000 (katërmëdhjetë mijë) euro është kryer më 20.12.2017, në llogarinë bankare pranë BKT-së në emër të shoqërisë dhe pagesa e dytë prej 14.120 (katërmëdhjetë mijë e njëqind e njëzet) euro ose 1.718.404 (një milion e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e katër) lekë është shlyer më 25.7.2019. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dhëna në pyetësin standard për këtë pasuri, sqaron se pas kolaudimit të objektit sipërfaqja e apartamentit prej 60 m² + 8.3 m² sipërfaqe e përbashkët ka ndryshuar dhe ka rezultuar të jetë 61.30 m² + 9 m² sipërfaqe e përbashkët. Për rrjedhojë çmimi i shitjes prej 27.320 (njëzet e shtatë mijë e treqind e njëzet) euro, i përcaktuar në Kontratën e Porosisë të vitit 2017 ka ndryshuar në vlerën 28.120 (njëzet e tetë mijë e njëqind e njëzet) euro, i përcaktuar në kontratën e vitit 2019.

7.2 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2017 blerjen e kësaj pasurie me vendndodhje në Dajt, nëpërmjet Kontratës së Porosisë të nënshkruar në datën 18.12.2017, në vlerën totale 27.320 (njëzet e shtatë mijë e treqind e njëzet) euro, për të cilën është likuiduar vlera 14.000 (katërmëdhjetë mijë) euro dhe debia e mbetur është 13.320 (trembëdhjetë mijë e treqind e njëzet) euro.

7.3 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2018 detyrimin e pashlyer në vlerën 13.320 (trembëdhjetë mijë e treqind e njëzet) euro ndaj shoqërisë “****” sh.p.k.

7.4 Drejtoria vendore e ASHK-së Tirana Rurale 1 konfirmon¹² pasurinë e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit duke përcjellë edhe dokumentacionin e disponuar.

7.5 Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se:

a) Subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar Kontratën e Porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.12.2017, me palë sipërmarrëse shoqërinë “****” sh.p.k. për apartamentin e banimit me sip. 60 m² dhe sip. të përbashkët 8.3 m², pjesë e kompleksit të banimit të ndërtuar nga pala sipërmarrëse në Dajt.

b) Vlera prej 27.320 (njëzet e shtatë mijë e treqind e njëzet) euro, sipas kontratës, do të shlyhet me këste dhe, konkretisht, pagesa e parë prej 14.000 (katërmëdhjetë mijë) euro do të

¹⁰Shihni shkresat nr. *** prot., datë 30.9.2021 dhe nr. *** prot., datë 4.10.2021.

¹¹Shihni përgjigjen nr. 20 në pyetësin datë 31.8.2020.

¹²Shihni shkresën nr. *** prot., datë 15.12.2020.

likuidohet brenda 10 ditëve nga momenti i lidhjes së kontratës nëpërmjet bankës, ndërsa pjesa tjetër me marrëveshje midis palëve.

c) Subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria “****” sh.p.k., nëpërmjet Kontratës së Shitblerjes së Pasurisë së Paluajtshme me Rezervë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.6.2019, kanë përcaktuar që çmimi i kësaj pasurie të jetë në vlerën 28.120 (njëzet e tetë mijë e njëqind e njëzet) euro për shkak se nga kolaudimi ka rezultuar se sipërfaqja totale e apartamentit është 2 m² më shumë. Palët deklarojnë se ky apartament i është dorëzuar palës blerëse në korrik të vitit 2018 dhe kësti i mbetur i papaguar në vlerën 14.120 (katërmëdhjetë mijë e njëqind e njëzet) euro do të likuidohet nga subjekti i rivlerësimit pas disbursimit të kredisë nga “Raiffeisen Bank” deri në datën 13.9.2019.

ç) Kjo pasuri, sipas Certifikatës së Pronësisë datë 2.4.2019, ishte në emër të shoqërisë “****” sh.p.k. dhe, në vijim, me Certifikatën e Pronësisë datë 14.6.2019 është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit.

7.5.1 Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur, ndër të tjera, si dokumente në pyetësozin standard: (a) mandatpagesën nga BKT-ja; (b) kontratën e kredisë në “Raiffeisen Bank” datë 16.7.2019; (c) deklaratën noteriale të shitësit; dhe (ç) dokumentacionin e pronësisë.

7.5.2 Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se:

a) Sipas mandatpagesës së BKT-së, vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, në datën 20.12.2017 është kryer derdhja e vlerës 14.000 (katërmëdhjetë mijë) euro, në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.

b) Subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar Kontratën e Kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.7.2019, me palë “Raiffeisen Bank”, për vlerën 1.718.404 (një milion e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e katër) lekë. Sipas mandatpagesës së “Raiffeisen Bank”, datë 25.7.2019, subjekti i rivlerësimit ka derdhur në emër të noteres A. M. vlerën prej 1.728.288 (një milion e shtatëqind e njëzet e tetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë) lekësh me përshkrimin “kalim sipas Kontratës nr. *** rep., nr. *** kol.”.

c) Në vijim është hartuar Deklarata Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.9.2019, nga shoqëria “****” sh.p.k., e cila deklaroi se vlera e apartamentit është likuiduar dhe inskriptimi i vendosur nga ASHK-ja në favor të kësaj shoqërie të fshihet dhe prona të jetë e inskriptuar vetëm në favor të “Raiffeisen Bank”, që ka lëvruar kredinë.

ç) Kjo pasuri, sipas kartelës së pasurisë, se në datën 18.7.2019, është inskriptuar në favor të “Raiffeisen Bank” deri në likuidimin e vlerës së kredisë.

7.6 OSHEE konfirmon¹³ kontratë energjie elektrike në emër të subjektit të rivlerësimit dhe nga detajet e pagesës konstatohet se faturimi ka nisur në shtator të vitit 2018.

7.7 UKT-ja konfirmon¹⁴ kontratë furnizimi në emër të subjektit të rivlerësimit dhe nga detajet e pagesës konstatohet se faturimi ka nisur në gusht të vitit 2018.

7.8 Komisioni, ka hetuar për raste të mundshme të konflikt interesi me shoqërinë “****” sh.p.k., duke pyetur Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat dhe, nga përgjigjet¹⁵, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka gjykuar ndonjë çështje me palë ndërgjyqëse këtë shoqëri.

7.9 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2017 si burim të ardhurash për shlyerjen e këstit të parë vlerën 14.000 (katërmëdhjetë mijë) euro: (a) kursimet e tërhequra

¹³Shihni shkresën nr. *** prot., datë 7.10.2021.

¹⁴Shihni shkresën nr. *** prot., datë 4.10.2021.

¹⁵Shihni shkresat nr. *** prot., datë 30.9.2021 dhe nr. *** prot., datë 4.10.2021.

nga llogaria në fondin e investimit në “Raiffeisen Bank”; (b) kursimet personale nga paga; (c) huan në vlerën 4.500 (katër mijë e pesëqind) euro nga shtetasi K. P. (vëllai); (ç) dhuratën në vlerën 2.500 (dy mijë e pesëqind) euro nga prindërit M. dhe Sh. P..

7.10 Komisioni ka verifikuar këtë pasuri dhe nuk ka konstatuar problematika. Po ashtu, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, ka vlerësuar se verifikimi i pasurive të subjektit pas periudhës së deklaratës *Vetting* e në vijim është një proces që duhet të kryhet nga organet kompetente të përcaktuara sipas ligjit. Ky arsytim vjen edhe bazuar në vendimin nr. 25/2020 të Kolegjit.

8. Analiza financiare për periudhën 10.1.2011 – 2016

8.1 Komisioni, bazuar në dokumentacionin e disponuar dhe në deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, kreu analizën paraprake të treguesve financiarë për periudhën 10.11.2011 – 2016, nga ku subjekti i rivlerësimit nuk rezulton në pamundësi financiare për periudhën e rivlerësimit.

8.2 Komisioni, gjatë hetimit administrativ të kryer për subjektin e rivlerësimit, ka hetuar edhe për personat e lidhur, prindërit e subjektit, pasuritë e tyre, të ardhurat e deklaruara ndër vite dhe për fitimin e realizuar. Nga hetimi nuk kanë rezultuar të dhëna apo *indicie* për pasuri të tjera të subjektit të rivlerësimit apo për personat e lidhur me të, të padeklaruara prej saj.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë

16. Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të saktë në deklaratën *Vetting* dhe ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e realizuara ndër vite. Pasaktësia e konstatuar në deklaratimin për herë të parë në raport me deklaratimet periodike vjetore lidhur me gjendjen *cash*, nga hetimi nuk rezultuan se kanë qenë të qëllimshme apo kanë pasur si synim fshehje të pasurive apo deklaratim të rremë. Subjekti nuk rezultoi në ndonjë rrethanë të konfliktit të interesit.

Trupi gjykues, nga hetimi i kryer dhe vlerësimi i dokumenteve të administruara në dosje, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

17. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, ka dërguar në datën 31.10.2017 raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin Rudina Palloj, duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës, raport të cilin e ka deklasifikuar plotësisht.

18. Komisioni i ka kërkuar DSIK-së përditësim të informacionit lidhur me subjektin e rivlerësimit Rudina Palloj, përderisa raporti pararendës kishte kryer verifikimet deri në tetor të vitit 2017 dhe deklasifikim. DSIK-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 5.10.2021, ka deklasifikuar raportin për këtë subjekt rivlerësimi.

19. Komisioni i kërkoi informacion Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin e rivlerësimit, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 1.12.2020, ka përcjellë informacion nga prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, nga ku nuk rezulton të ketë çështje penale apo kallëzime penale të filluara ndaj subjektit të rivlerësimit.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës

20. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së dhe informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaratimit

për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë e përfshirë, apo e vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe, si rrjedhojë, e gjen atë të përshtatshme për vazhdimin e detyrës.

Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Rudina Palloj ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

21. Ky raport është mbështetur në raportin e paraqitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit, në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, informacione të marra nga burime të tjera sipas ligjit, si dhe kriteret e vlerësimit të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

22. Nga vlerësimi i dokumenteve ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit Rudina Palloj ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj janë të kuptueshme. Ajo respekton, përgjithësisht, rregullat e drejtshkrimin dhe përdor karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Gjyqtarja nuk paraqet gabime ortografike dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe (shihni dokumentet 1, 2, 3 në dosjet 1, 2, 3, 4, 5).

23. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja Rudina Palloj i ka kushtuar rëndësi, përgjithësisht, arsyetimit në kohën e duhur të vendimeve gjyqësore. Vetëm në një rast vendimi i arsyetuar është dorëzuar pas 11 ditësh, duke kaluar afatin e arsyetimit me 1 ditë (shihni dosjen 2).

24. Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Rudina Palloj.

25. Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Rudina Palloj komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe duke respektuar barazinë e palëve. Në të dyja dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

TË DHËNA NGA BURIMET ARKIVORE TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

26. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Rudina Palloj janë paraqitur pesë ankesa (katër në vitin 2014 dhe një në vitin 2015), pranë Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

26.1 Tri ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, ku një prej tyre me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor, rasti i dytë me arsyetimin se është ankesë e përsëritur dhe rasti i tretë se është jashtë kompetencave të Inspektoratit.

26.2 Një ankesë është verifikuar për zvarritje dhe, në përfundim, është sugjeruar “tërheqje vëmendjeje me shkrim”. Një ankesë është verifikuar për mosrespektim formal të ligjit, e cila është në vijim verifikimi deri në përfundim të gjykimit në gjykatat më të larta.

27. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Rudina Palloj, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

28. Lidhur me të dhënat sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në vijim të prapësimeve sa më poshtë vijon:

- Subjekti i rivlerësimit, për sa i përket ankesës së verifikuar për zvarritje për të cilën në përfundim të shqyrtimit është sugjeruar “tërheqje vëmendjeje” nga inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, shpjegon se nga ana e organit që ka shqyrtuar ankesën nuk i është komunikuar asnjëherë ky akt/veprim administrativ. Subjekti i rivlerësimit sqaron se me këtë sugjerim është njohur për herë të parë në datën 9.12.2021, kur ka marrë praktikën e kërkuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, dhe citon se: *“Ky fakt rezulton tërësisht i provuar edhe nga shkresa përkatëse e njoftimit drejtuar gjyqtarit, e cila nuk ka as numër protokolli, as datë, as emrin dhe as nënshkrimin e zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Pra, ky njoftim/shkresë nuk është nisur dhe, për pasojë, nuk ka mbërritur asnjëherë tek unë. Për pasojë, në momentin që jam njohur me këtë praktikë, duke e konsideruar tërësisht të pabazuar në ligj si në aspektin procedural ashtu edhe në atë të përmbajtjes, jam duke vlerësuar mundësinë për të ndjekur rrugën ligjore për kundërshtimin e saj nëpërmjet paraqitjes së një padie pranë gjykatës kompetente”.*

Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si dokument shkresën nr. *** prot., datë 9.12.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nga ku rezulton se ankesa në fjalë i përket vitit 2015 me ankues shtetasin E. G.. Pjesë e dokumentacionit është edhe një shkresë e ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë adresuar subjektit të rivlerësimit për komunikimin e masës tërheqje vëmendje me shkrim për zvarritje gjykimi. Në këtë shkresë citohet se nga verifikimi i ankesës së shtetasit E. G. rezultoi se gjykimi i çështjes ka tejkaluar afatin me dy muaj. Por kjo shkresë përmban vetëm vulën e institucionit dhe nuk ka siglim, numër protokolli dhe datë.

Subjekti i rivlerësimit argumenton se sugjerimi për tërheqje vëmendjeje i Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është dhënë duke u bazuar në nenin 24 të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, e cila i njihet të drejtën zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të tërhiqte vëmendjen e gjyqtarëve për sjellje që nuk parashikoheshin nga ligji si shkelje disiplinore shumë të rënda, të rënda apo të lehta, duke u bërë pjesë e dosjes së vlerësimit, por ky parashikim i rregullores është shfuqizuar nga vetë Këshilli i Lartë i Drejtësisë, pasi ishte në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 8811/2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” dhe dilte jashtë fushës së veprimtarisë që duhet të rregullonte ky akt. Subjekti i rivlerësimit citon se: *“Përveçse në kundërshtim me ligjin, ky nen i rregullores cenonte në mënyrë të drejtpërdrejtë dispozitat kushtetuese dhe, konkretisht, nenet 116 dhe 118, të cilat përcaktojnë parimin e hierarkisë së normave dhe konceptin e rezervës ligjore, nenin 119 në lidhje me natyrën e rregullores si akt normativ, nenin 145 që përcakton parimin e pavarësisë së gjyqtarit, si dhe nenin 147, pikat 1 dhe 4, të Kushtetutës që parashikon kompetencat ekskluzive vetëm të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për të disponuar mbi masat që ndikojnë në vlerësimin apo ecurinë e karrierës së gjyqtarit. Sa më sipër, kompetenca që ka ushtruar Kryeinspektori duke sugjeruar ‘tërheqje vëmendjeje’ nëpërmjet një akti apo veprimi administrativ të hartuar tërësisht jashtë kompetencave të tij, ka cenuar kuadrin ligjor dhe kushtetues në fuqi në kohën e kryer të këtij disponimi”.*

Sipas arsyetimit të subjektit të rivlerësimit sugjerimi për tërheqje vëmendjeje nuk është miratuar, pasi shkresa e adresuar gjyqtarit nuk ka nënshkrimin e zëvendëskryetarit, as datë dhe numër protokolli.

- Referuar përmbajtjes së praktikës mbi këtë rast të vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit rezulton se pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë është administruar shkresa nr. *** prot., datë 23.3.2015, e shtetasit E. G. lidhur me veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarës Rudina Palloj. Në vijim është miratuar urdhri nr. ***, datë 29.5.2015, për verifikimin e kësaj ankese. Sipas raportit të miratuar nga kryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë është konstatuar se gjykimi për këtë çështje ka tejkaluar me dy muaj afatin e gjykimit, i cili për këto kategori çështjesh është 6 muaj. Në këtë raport cilësohet se: *“Mangësitë e konstatuara më sipër në planifikimin dhe organizimin e punës nga ana e kryesueses së çështjes, janë rezultat i mungesës së përvojës së gjyqtarës Rudina Palloj, pasi po të analizojmë në tërësi veprimet e tjera sikurse janë vënia me shpejtësi në lëvizje e çështjes, thirrja e personave të tretë të domosdoshëm në këtë lloj gjykimi, përpjekja e gjyqtarës për të lënë seanca në një afat sa më të shkurtër, si dhe fakti që vetë gjyqtarja nuk ka munguar në asnjë seancë nuk krijojnë bindjen se gjyqtarja ka pasur si qëllim zvarritjen e gjykimit”*. Në përfundim të këtij raporti është konkluduar për arkivimin e ankesës së shtetasit E. G. në adresë të veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarës dhe tërheqjen e vëmendjes me shkrim gjyqtarës për shkeljet e konstatuara. Ky vendim i është njoftuar zyrtarisht edhe shtetasit E. G., i cili në vijim ka ridërguar sërish ankesa të përsëritura për gjyqtaren.

Subjekti i rivlerësimit gjykon se konstatimet që kanë çuar inspektorët përkatës dhe më pas kryeinspektorin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në këtë konkluzion janë të pambështetura edhe në aktet e dosjes gjyqësore që kanë administruar dhe shqyrtuar gjatë verifikimit të kësaj ankese dhe, për këtë shprehet, se: *“Vlerësoj se konkluzionet e inspektorëve lidhur me disa seanca të shtyra që sipas tyre janë bërë për shkak të mosmenaxhimit të çështjes vetëm nga gjyqtari kryesues, janë tërësisht të pambështetura, çka rezulton e qartë nga vendimet përkatëse të shtyrjes së tyre, të cilat janë në çdo rast të arsyeuara, të shoqëruara me referencën ligjore përkatëse, si dhe me masat konkrete që gjykata ka urdhëruar të merren me qëllim zhvillimin e procesit në kohë. Kohëzgjatja e gjykimit në raport me afatet orientuese të përcaktuara nga organi kompetent nuk mund të vlerësohet duke matur matematikisht kohëzgjatjen e gjykimit, por duhet vlerësuar në raport me faktorët që kanë ndikuar në këtë proces”*.

- Lidhur me ankesën për mosrespektim formal të ligjit, subjekti i rivlerësimit shprehet se: *“Kjo ankesë i përket avokatit të të pandehurit L. M. në çështjen penale të përfunduar me vendimin nr. ***, datë 12.3.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, çështje në të cilën unë kam qenë gjyqtare relator/kryesues. ILD-ja pas trajtimit të ankesës me vendimin nr. *** prot., datë 25.11.2021, ka vendosur arkivimin e saj duke mos i gjetur të bazuara pretendimet e ankuesit, të cilat konsistojnë në pretendimin për mosrespektimin e ligjit procedural dhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese mbi bazën e të cilit kjo çështje është kthyer për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat”*.

Subjekti ka vënë në dispozicion një kopje të vendimit të marrë nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë pas verifikimit të ankesës. Sipas Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë pretendimi i ankuesit ndaj vendimit nr. ***, datë 12.3.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat nuk është gjetur i bazuar, pasi ky vendim gjatë kontrollit gjyqësor nga një gjykatë më e lartë është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 11.5.2020. Njëkohësisht, nga të dhënat e grumbulluara nuk rezultuan fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratëve.

- Lidhur me mosrespektimin e vendimeve nr. ***, datë 3.4.2011 dhe nr. ***, datë 4.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese, subjekti i rivlerësimit shprehet se: *“Po ashtu, gjykatat më të larta që kanë shqyrtuar ankimet e palëve ndaj vendimeve të ndërmjetme lidhur me humbjen e fuqisë së*

paraburgimit, revokimin e masës së sigurisë, si dhe ndaj vendimit përfundimtar për deklarimin fajtor të të pandehurit nuk është konstatuar në asnjë moment mosrespektimi i ligjit procedural, ligjit material dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga gjykata e shkallës së parë”.

Subjekti ka vënë në dispozicion si dokumentacion vendimet e dhëna nga gjykatat për këtë çështje.

Nga shqyrtimi i akteve rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me relatores subjektin e rivlerësimit, ka vendosur me vendimin nr. ***, datë 12.3.2018, deklarimin fajtor të shtetasit L. M. për akuzat e vrasjes në rrethana të tjera cilësuese dhe prodhimit të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municioneve luftarake, bashkimin e dënimeve dhe dënimin me burgim të përjetshëm. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila me vendimin nr. ***, datë 11.5.2020, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

DENONCIMET

29. Në Komision janë paraqitur 7 (shtatë) denoncime dhe vetëm 1 (një) prej tyre i drejtohet subjektit të rivlerësimit si gjyqtare e vetme, të tjerët i drejtohen trupit gjykues ose një grupi gjyqtarësh si në vijim:

1. Denoncim i shtetasit A. J. (bashkim i tri denoncimeve). Objekti i denoncimit: denoncon disa subjekte rivlerësimi për zvarritje gjykimi dhe dhënie dorëheqjeje në mënyrë të pajustificuar.

1.1 Nga denoncuesi janë dorëzuar tri denoncime që lidhen me disa subjekte, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, duke pretenduar se gjyqtarët kanë pranuar kërkesën e palës paditëse për dhënie dorëheqjeje nga gjykimi i çështjes dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat është bërë vegël duke u treguar e njëanshme dhe duke i shkaktuar dëm palës së paditur për njohjen pronar mbi pronat e trashëguara. Denoncuesi nuk ka bashkëlidhur asnjë dokumentacion apo çështje konkrete të pretenduar.

1.2 Në përfundim të analizës denoncimi nuk plotëson kërkesat e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, e nuk përmban fakte dhe rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.

2. Denoncim i shtetasës D. B. Objekti i denoncimit: denoncon subjektin e rivlerësimit dhe një gjyqtare tjetër për zvarritje procesi gjyqësor, gjykim të padrejtë, gjykim të njëanshëm dhe shkelje të një procesi të rregullt ligjor duke pretenduar se subjekti i rivlerësimit nuk duhet të kishte gjykuar çështjen, por duhet të kishte kthyer padinë për plotësim të metash, pasi testamenti i vitit 1988 nuk është dorëzuar së bashku me kërkesëpadinë nga pala paditëse.

2.1 Referuar akteve të denoncimit rezulton se shtetasi A. B. dhe familjarët e tij janë në një marrëdhënie konfliktuale për shkak të mosmarrëveshjeve të krijuara nga testamenti i lënë nga babai i tyre në vitin 1988, i cili kishte caktuar si trashëgimtar të vetëm ligjor të pasurive të tij djalin A. B.. Subjekti i rivlerësimit ka gjykuar çështjen civile me palë të paditur shtetasin A. B. me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të testamentit datë 8.2.1988 dhe Dëshmisë së Trashëgimisë testamentare nr. ***, datë 13.3.1990, bërë nga testatori M. B.. Subjekti, me vendimin nr. ***, datë 12.2.2018, ka vendosur konstatimin pjesërisht absolutisht të pavlefshëm të testamentit duke njohur palën paditëse trashëgimtare ligjore në këtë pasuri.

Nga verifikimi ka rezultuar se çështja civile me palë të paditur shtetasin A. B. me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të testamentit datë 8.2.1988 dhe Dëshmisë së Trashëgimisë testamentare nr. ***, datë 13.3.1990, bërë nga testatori M. B., është ankuar në Gjykatën e Apelit, e cila nuk e ka shqyrtuar ende këtë çështje.

2.2 Denoncuesi ka paraqitur ankim në Ministrinë e Drejtësisë kundër subjektit të rivlerësimit dhe një gjyqtareje tjetër. Nga verifikimi ka rezultuar se Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. *** prot., datë 13.2.2018, ia ka përcjellë verifikimin e ankesës së shtetasit A. B., për kompetencë, Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Komisioni ka kryer verifikim në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë (ish Inspektorati i KLD-së) lidhur me ankesën e përcjellë nga Ministria e Drejtësisë, nga ku rezultoi¹⁶ se pas shqyrtimit, ankesa është arkivuar me vendimin nr. *** , datë 17.2.2021.

2.3 Nga verifikimi i bërë nga Komisioni ka rezultuar se lidhur me pretendimin e denoncuesit që subjekti i rivlerësimit duhet të kthente padinë për plotësim të metash bazuar në nenet 154¹⁷ dhe 154/a¹⁸ të Kodit të Procedurës Civile konstatohet se nuk ndodhet në rrethanat e parashikuara nga këto nene në lidhje me të metat e padisë, sepse pala paditëse nuk e dispononte atë akt (testamentin), pasi ishte në kushtet e pamundësisë dhe ia kërkonte gjykatës që ta gjente dhe administronte si provë.

2.4 Në përfundim trupi gjykues vlerëson se ky denoncim nuk ka element që mund të mbahet në konsideratë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

3. Denoncim i Dhomës së Avokatisë Berat. Objekti i denoncimit: denoncon për mosofrim shërbimi dhe korrupsion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat duke referuar të gjithë gjyqtarët.

3.1 Denoncuesi ankohet për shumë subjekte, të cilët sipas tij kanë krijuar pasuri nëpërmjet aferave korruptive. Denoncuesi pretendon për subjektin e rivlerësimit se ofendon palët në seancat gjyqësore, si dhe ngre pikëpyetje për shoqërimin e gjyqtares Rudina Palloj me avokaten F. E..

3.2 Në vijim, Komisioni ka vlerësuar t'i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat duke kërkuar informacion mbi çështje gjyqësore të shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit me palë ndërgjyqëse të përfaqësuar nga av. F. E..

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka informuar¹⁹ se gjyqtarja Rudina Palloj ka gjykuar për periudhën vjetore 2014 – 2019, në total 84 çështje gjyqësore të regjistruara me palë ndërgjyqëse të përfaqësuar nga av. F. E., duke përcjellë edhe kopje të vendimeve. Nga shqyrtimi i vendimeve gjyqësore rezulton se gjyqtarja është shprehur për 27 çështje gjyqësore në favor të palës ndërgjyqëse të përfaqësuar nga avokate F. E., për 18 çështje gjyqësore në favor të palës kundërshtare, për 28 çështje gjyqësore vendimi ka qenë favorizues për kërkimet e të dyja palëve ndërgjyqëse, për 7 çështje gjyqësore është pushuar gjykimi, për 1 çështje gjyqësore është shpallur moskompetencë lëndore dhe në 3 çështje gjyqësore vendimet kanë rrëzuar pretendimet e palëve.

Konstatohet se për 53 çështje gjyqësore vendimi ka marrë formë të prerë dhe nuk është apeluar në gjykatë të shkallës më të lartë nga palët ndërgjyqëse.

¹⁶Shihni shkresën nr. *** prot., datë 23.11.2021.

¹⁷Kërkesëpadia shkruhet në gjuhën shqipe dhe duhet të përmbajë: gjykatën përpara së cilës paraqitet kërkesa; emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin e paditësit e të paditurit dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ata, kur ka të tillë; përcaktimin e objektit të kërkesëpadisë; tregimin e fakteve, rrethanave, dokumenteve, mjeteve të tjera provuese dhe të së drejtës mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia; kërkimin e paditësit; vlefën e padisë, në rast se objekti i saj është i vlerësueshëm. Përveç këtyre kërkesave, paditësi në kërkesëpadi duhet të tregojë saktë: (a) të dhënat elektronike të kontaktit të tij ose të përfaqësuesit, nëse ka një të tillë, në të cilin gjykata mund ta njoftojë, si dhe deklaratën e pranimit të njoftimit me mjete të komunikimit elektronik; (b) listën e personave që kërkon të thirren në gjykim, duke saktësuar emrin, atësinë, mbiemrin dhe adresën e plotë të tyre. Paditësi, për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës dhe të dhënave elektronike të kontaktit të tij ose të përfaqësuesit detyrohet të njoftojë gjykatën. Shkelja e këtij detyrimi i bën të papranueshme pretendimet për pavlefshmërinë e njoftimit.

¹⁸Kërkesëpadia paraqitet në gjykatë nga paditësi ose nga përfaqësuesi i tij i pajisur me prokurë. Kërkesëpadia mund të paraqitet në gjykatë edhe nëpërmjet postës. Padia iu caktohet gjyqtarëve me short. Kur kërkesëpadia nuk plotëson kushtet e përmendura në këtë kre, gjyqtari i vetëm ia kthen paditësit në kohën e paraqitjes së saj ose ai njoftohet me shkrim për plotësimin e të metave dhe, pasi të jetë shënuar në padi data e paraqitjes, caktohet një afat për plotësimin e të metave. Deri në këtë datë padia mbetet pa veprime. Kodi i Procedurës Civile viti 2014, f. 34: “Kur paditësi nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar, kërkesëpadia quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet paditësit së bashku me aktet e tjera. Kundër vendimit të gjyqtarit të vetëm për kthimin e kërkesëpadisë mund të bëhet ankim i veçantë. Kur të metat e kërkesëpadisë janë plotësuar në afatin e caktuar, ajo quhet e regjistruar që nga dita që është regjistruar në gjykatë. Në këtë mënyrë veprohet edhe kur të metat e kërkesëpadisë konstatohen gjatë gjykimit të çështjes”.

¹⁹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 14.10.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Në 9 çështjet gjyqësore të apeluara nga palët, Gjykata e Apelit Vlorë i ka konsideruar të drejta vendimet e shkallës së parë duke i lënë në fuqi. Vetëm për 1 çështje gjyqësore Gjykata e Apelit Vlorë ka lënë në fuqi vendimin me një ndryshim në masën e sigurimit personal.

3.3 Gjatë hetimit nuk kanë rezultuar të dhëna konkrete për lidhje miqësore mes gjyqtarës dhe avokates, as denoncuesi nuk ka paraqitur fakte apo të dhëna konkrete, të cilat mund të hetoheshin nga Komisioni.

3.4 Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë denoncim, e cila shpjegon se: *“Në të gjitha çështjet e shqyrtuara gjatë ushtrimit të detyrës kam respektuar maksimalisht aspektet e parimit të procesit të rregullt ligjor, ndër të cilat ato më thelbësoret që lidhen me funksionin e gjyqtarit, sikurse janë parimi i pavarësisë, paanësisë dhe barazisë së palëve në proces. Sa i përket aludimeve të denoncuesit anonim në drejtimin tim, këto pretendime janë absolutisht të pavërteta, dashakeqe dhe të pabazuara. Marrëdhënia ime me avokaten e referuar ka qenë një marrëdhënie korrekte dhe normale, si me të gjitha palët dhe subjektet procedurale në gjykim. Për këtë arsye i gjej tërësisht absurde dhe thellësisht të pavërteta aludimet e letërshkruesit anonim në drejtimin tim”*.

3.5 Në përfundim, pasi u analizua ky denoncim dhe rezultatet e hetimit, nuk u evidentua ndonjë shkelje ligjore apo veprim i kryer nga subjekti i rivlerësimit që cenon figurën apo aftësitë e saj profesionale.

4. Denoncim i shtetasit P. D. (bashkim i dy denoncimeve). Objekti i denoncimit: denoncon subjektin e rivlerësimit për paaftësi profesionale, njëanshmëri.

4.1 Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka lëshuar një urdhërkzekutimi në favorizim të palës kundërshtare duke anashkaluar vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë. Referuar akteve të denoncimit rezulton se subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 3.5.2012, ka pranuar lëshimin e urdhërkzekutimit të kërkuar nga shtetasi V. S. sipas Deklaratës Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.9.2008, vetëm për pjesën e kësaj deklarate që ka të bëjë me detyrimin monetar të shtetasit P. D..

4.2 Ky denoncues ka qenë palë paditëse në disa procese gjyqësore që janë zhvilluar ndër vite në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe në Gjykatën e Apelit Korçë lidhur me marrëdhënien e huas me palën në konflikt, shtetasin V. S.. Nga aktet e denoncimit rezulton se denoncuesi ka paraqitur ankesë pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për subjektin e rivlerësimit dhe disa subjekte të tjera, por ky institucion, me vendimin nr. *** prot., datë 29.12.2020, ka arkivuar shqyrtimin fillestar të ankesës së paraqitur nga denoncuesi me pretendimin se është jashtë periudhës së parashkrimit të shkeljes disiplinore.

4.3 Nga verifikimi i të dhënave publike²⁰ në internet rezulton se denoncimi i këtij shtetasi është trajtuar edhe nga një emision investigativ për pretendimin e influencës së ushtruar nga pala kundërshtare në procese gjyqësore dhe një përmbarues privat në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë (grup gjyqtarësh) dhe në kadastër për tjetërsimin e pronave. Pretendimi lidhur me subjektin Rudina Palloj, gjyqtare e çështjes që ka lëshuar urdhërkzekutimin, është se ai nuk duhej lëshuar.

4.4 Lidhur me pretendimin e denoncuesit që subjekti i rivlerësimit nuk duhet të kishte lëshuar urdhërkzekutim për një akt noterial, Komisioni verifikoi vendimin e dhënë nga gjyqtarja në raport me legjislacionin në fuqi, bazuar në germën “d”, të nenit 510²¹, të Kodit të Procedurës

²⁰<https://tvklan.al/merr-para-me-fajde-nga-ish-doganieri-ky-i-fundit-i-grabit-pronen-me-manipulim/>

²¹Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv. Janë tituj ekzekutivë: (a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm; (b) vendimet penale të formës së prerë në pjesën që bëjnë fjalë për të drejta pasurore; (c) vendimet e gjykatave e të arbitrazheve të shteteve të huaja që u është dhënë fuqi sipas dispozitave përkatëse të këtij Kodi; (ç) vendimet e një gjykate arbitrazhi në Republikën e Shqipërisë; (d) aktet noteriale që përmbajnë detyrim në të holla, si dhe aktet për dhënien e kredive bankare ose aktet për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare; (dh) kambialet, çeqet e letrat me urdhër që barazohen me ato; (e) aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përmbarrimit për ekzekutimin e tyre.

Civile dhe akti noterial që përmban detyrim në të holla klasifikohet si titull ekzekutiv dhe germa “ç”, e nenit 511²², të Kodit të Procedurës Civile parashikohej se për këtë rast gjykata lëshonte urdhërekzekutim.

4.5 Në përfundim rezulton se gjyqtarja ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore. Nga verifikimi i akteve nuk u evidentuan fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova lidhur me kriterin e vlerësimit profesional.

5. Denoncim i shtetasit Th. P. Objekti i denoncimit: denoncon dy subjekte rivlerësimi për falsifikim dokumentesh, mashtrim, shpërdorim detyre, abuzime, kërcënime dhe korrupsion.

5.1 Denoncuesi pretendon se subjektet e rivlerësimit, që kanë shqyrtuar çështjen gjyqësore ku ai është palë për një konflikt bashkëpronësie, janë të korruptuar. Konkretisht, për subjektin Rudina Palloj denoncuesi pretendon se ka qenë e blerë nga pala tjetër dhe shtynte pa shkak seancat duke shkelur parimin e paanshmërisë.

5.2 Referuar akteve të paraqitura nga denoncuesi, rezulton se ai ka paraqitur këtë ankesë edhe në Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe në SPAK, nga ku rezultoi se Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me shkresën nr. *** prot., datë 29.6.2016, ka njoftuar denoncuesin për arkivimin e ankesës së paraqitur që lidhet me mënyrën e zgjidhjes së çështjes gjyqësore.

5.3 Komisioni, nga investigimi në internet, është vënë në dijeni mbi disa të dhëna në formë denoncimi të marra nga portalet mediatike <https://telegraf.al/drejtesia/thanas-papa-zvarritjet-e-proceseve-gjyqesore-ne-gjykatën-e-rrethit-gjyqesor-berat/>, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit ka zvarritur procesin gjyqësor dhe ka përplasur dyert duke fyer avokatin dhe paditësin. Kjo çështje lidhet pikërisht me atë të denoncuar nga shtetasi Th. P..

5.4 Lidhur me këto të dhëna, Komisioni kërkoi informacion dhe kopje dokumentacioni nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat.

5.4.1 Nga verifikimi i akteve të vëna në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat²³ rezulton se çështja civile e sipërcituar është regjistruar në gjykatë në datën 7.2.2014 dhe, sipas shortit elektronik në datën 10.2.2014, është caktuar gjyqtare Rudina Palloj, e cila ka planifikuar në datën 14.2.2014 seancën gjyqësore për t’u zhvilluar në datën 24.2.2014. Në vijim, sipas dokumentit “regjistri i veprimeve”, të dërguar nga gjykata, janë caktuar 9 seanca gjyqësore të cilat janë shtyrë, në disa raste jepen arsytet të cilat rezultojnë me kërkesë të palës paditëse ose për t’u njohur me aktet në dosje dhe në disa raste për mosparaqitjen e palës së paditur duke dhënë shkaqe. Jo në çdo rast ka informacion lidhur me shkaqet konkrete të shtyrjes së seancave.

Në datën 30.6.2014 gjyqtarja ka paraqitur kërkesën për dorëheqje nga çështja, pasi pala paditëse ka reaguar disa ditë më parë mbi sjelljet e përsëritura të gjyqtares për shtyrjen e seancave dhe pranimin e kërkesës së të paditurit dhe avokatit të tij, si dhe një artikulli bazuar në një portal, ku paditësi akuzon gjyqtaren për shtyrje të seancave gjyqësore me qëllim zvarritjen e procesit. Gjyqtarja, me qëllim garantimin e një procesi të rregullt ligjor, ka paraqitur kërkesën e saj për dorëheqje. Kërkesa është pranuar në datën 30.6.2014 nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat si e bazuar në ligj. Kjo çështje, në vijim, është zgjidhur me vendimin e datës 7.11.2014 nga gjyqtari D. H..

5.5 Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit lidhur me numrin e lartë të seancave të shtyra dhe qëndrimin e saj për këtë denoncim.

²²Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim me kërkesën e kreditorit. Për këtë qëllim lëshohet urdhërekzekutimi, i cili jepet: ç. për rastet e parashikuara nga gjerat “d”, “dh” dhe “e” nga gjykata e vendit ku është caktuar të bëhet ekzekutimi. Ankimi për mosdhënien e urdhërekzekutimit.

²³Shihni shkresën nr. *** prot., datë 12.11.2021.

5.6 Subjekti i rivlerësimit, në prapësime citon se: *“Në asnjë rast nuk rezulton që nga ana e gjykatës të mos jenë marrë masat e duhura procedurale për të garantuar zhvillimin e gjykimit në seancën vijuese dhe njoftimin e rregullt të palëve apo përfaqësuesve të tyre. Shtyrja e seancave është në çdo rast e argumentuar dhe me referencat ligjore përkatëse duke u marrë të gjitha masat për të garantuar njoftimin e rregullt, pjesëmarrjen e palëve në gjykim, si dhe garantimin e të drejtës së përfaqësimit. Rezulton se shtyrja e seancave është shkaktuar gjithnjë nga kërkesat apo sjellja e palëve dhe mbrojtësve të tyre dhe në asnjë rast për mungesë të aftësive organizative të gjyqtarit”.*

Lidhur me pretendimet e denoncuesit për njëanshmëri, shpërdorim detyre etj., ato janë në mënyrë absolute të pavërteta, tërësisht abuzive dhe pa asnjë bazë faktike dhe as hipotetike të mundshme.

Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si dokument kopje të procesverbaleve të përmbledhura të 9 seancave gjyqësore të zhvilluara me palë ndërgjyqëse shtetasin Th. P.. Nga verifikimi i procesverbaleve konstatohet se arsyet që kanë çuar në shtytjen e seancave gjyqësore janë si rezultat i kërkesave të paraqitura nga palët për plotësim të aktit të përfaqësimit, për njohje me aktet që shoqërojnë padinë dhe për saktësim provash dhe, në disa raste, për shkak të mosparaqitjes së palëve duke dhënë shkaqe.

5.7 Në përfundim, pasi u analizua kjo çështje gjyqësore dhe gjithë dinamika e saj, nuk u evidentua ndonjë shkelje ligjore apo veprim i kryer nga subjekti i rivlerësimit që cenon figurën apo aftësitë e saj profesionale.

6. Denoncim i shtetasit S. N.. Objekti i denoncimit: denoncon për mosrespektim ligji dhe arsyetim arbitrar.

6.1 Denoncuesi ankohet për kundrejt gjashtë subjekteve që kanë gjykuar në trupa gjyqësore, përkatësisht, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat (tre) dhe në Gjykatën e Apelit Vlorë (tre) të cilët, sipas tij, kanë bërë shkelje tërësore profesionale për të favorizuar njërin palë dhe janë korruptuar. Denoncuesi pretendon se arsyetimi i vendimit nga trupi gjykues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, ku bënte pjesë edhe subjekti i rivlerësimit, ka qenë konfuzion qëllimor, pasi kontrata e huas është trajtuar si kontratë porosie dhe nuk është ushtruar ekspertim lidhur me pretendimet e të paditurit të përfaqësuar nga ana e tij.

6.2 Referuar akteve të denoncimit rezulton se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, me vendimin nr. ***, datë 27.3.2018, ka vendosur pranimin e pjesëshëm të palës paditëse dhe detyrimin e palës së paditur për t'i paguar palës paditëse vlerën monetare përkatëse, së bashku me kamatëvonesa.

6.3 Nga verifikimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Apelit Vlorë, rezulton se vendimi nr. ***, datë 27.3.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat është ankimuar. Gjykata e Apelit Vlorë, pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve, ka vendosur në datën 5.9.2019 lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

6.4 Nga verifikimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë rezulton se kjo çështje është rekursuar dhe statusi aktual i çështjes është në proces.

6.5 Lidhur me këtë denoncim, subjekti i rivlerësimit sqaron se është caktuar si anëtare në fazën përfundimtare të hetimit gjyqësor, pas dhënies së dorëheqjes nga anëtari i mëparshëm dhe vendimmarrja e trupit gjykues mbi këtë çështje është bazuar tërësisht në provat e marra gjatë gjykimit, të cilat janë administruar pas një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm.

6.6 Subjekti i rivlerësimit, për sa i përket pretendimeve të denoncuesit për mosrespektim ligji dhe arsyetim arbitrar, shpjegon se kjo çështje ka qenë objekt gjykimi i një gjykate më të lartë, që e ka lënë në fuqi vendimin e dhënë: *“Pretendimet e ankuesit lidhur me themelin e*

vendimmarrjes dhe arsytimit e vendimit janë shqyrtuar nga gjykatat më të larta mbi bazën e mjeteve të ankimit, të cilat e kanë vlerësuar të drejtë dhe të bazuar vendimin përkatës. Sa i përket pretendimeve të tjera të denoncuesit, këto pretendime janë tërësisht të pavërteta dhe abuzive”.

6.7 Në përfundim, pasi u analizua kjo çështje gjyqësore dhe gjithë dinamika e saj, nuk u evidentua ndonjë shkelje ligjore apo veprim i kryer nga subjekti i rivlerësimit që cenon figurën apo aftësitë e saj profesionale.

7. Denoncim i shtetasit P. K.. Objekti i denoncimit: denoncuesi ankohet për subjektin e rivlerësimit dhe një gjyqtar tjetër për shkelje të rënda ligjore, korrupsion dhe vendimmarrje të padrejtë.

7.1 Denoncuesi pretendon se kjo gjyqtare ka fshehur pasurinë në emër tjetër, në vendimmarrjen që ka marrë ka kryer korrupsion pasiv dhe ka marrë një vendim të padrejtë duke iu referuar vendimit sa më poshtë.

7.2 Referuar akteve të denoncimit rezulton se, fillimisht, denoncuesi ka qenë palë në një çështje gjyqësore civile me objekt “kërkesë për përjashtim” nga shoqëria ku figuronte ortak. Sipas denoncuesit, pala paditëse ka paraqitur si prova dokumente joreale të falsifikuara, për të cilat është gjykuar për veprën penale “falsifikim dokumentesh”.

7.3 Nga verifikimi rezulton se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar çështjen civile me palë të paditur shoqërinë ku figuronte ortak denoncuesi me objekt përjashtimin e tij nga shoqëria. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 14.1.2013, ka pranuar padinë. Ky vendim është ankuar në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila me vendimin nr. ***, datë 28.5.2013, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 15.1.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë.

7.4 Ky denoncues ka qenë palë në disa procese gjyqësore dhe së fundmi sipas vërtetimit të datës 4.2.2021 të Gjykatës së Lartë rezulton se ky shtetas është në cilësinë e të pandehurit në çështjen gjyqësore nr. ***, datë 30.8.2019, për akuzat “falsifikim dokumentesh” dhe “deklarim të rremë”. Kjo çështje është në fazën e studimit dhe në pritje për t’u shqyrtuar.

7.5 Denoncuesi nuk ka dhënë *indicie* apo të dhëna për pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit.

7.6 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se pretendimet për shkelje të rënda ligjore dhe vendimmarrje të padrejtë nuk qëndrojnë dhe nuk janë të bazuara, pasi hetimi gjyqësor i çështjes është zhvilluar i plotë duke administruar dhe vlerësuar të gjitha provat e paraqitura nga palët ndërgjyqëse.

Lidhur me pretendimet për themelin e vendimmarrjes subjekti i rivlerësimit shpjegon se korrektësia dhe ligjshmëria e vendimmarrjes, në aspektin procedural dhe material, është bërë objekt kontrolli nga gjykatat më të larta dhe prej tyre nuk është konstatuar asnjë aspekt që mund të përbëjë shkelje të ligjit apo vendimmarrje të padrejtë.

7.7 Në përfundim, pasi u analizua kjo çështje gjyqësore dhe gjithë dinamika e saj, nuk u evidentua ndonjë shkelje ligjore apo veprim i kryer nga subjekti i rivlerësimit që cenon figurën apo aftësitë e tij profesionale.

8. Të dhëna në formë *indicie* konfidenciale për dy çështje gjyqësore penale të shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit, për të cilat Komisioni është vënë në dijeni dhe ka vlerësuar të arsyeshme të verifikojë *indiciet* e mbledhura dhe, për këtë arsye, i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat kopje të dy vendimeve gjyqësore, nga ku ka rezultuar sa vijon:

8.1 Vendimi²⁴ nr. ***, datë 13.11.2018 (regjistruar më 20.9.2018), me palë kërkuese Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat kundër të pandehurve B. I. dhe R. B., të akuzuar për veprat penale “vjedhje” dhe “përvetësim të parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtari kriminale”. Prokuroria²⁵ ka kërkuar deklarinin fajtor të të pandehurve B. I. dhe R. B., duke kërkuar 7 muaj burg dhe në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale të dënohen përfundimisht secili me 4 muaj e 20 ditë burgim. Gjyqtarja Rudina Palloj ka konkluduar në përfundim të gjykimit duke vendosur deklarinin fajtor të të pandehurve B. I. dhe R. B. dhe dënimin e tyre me 6 muaj burg dhe duke aplikuar nenin 406/1 të Kodit të Procedurës Penale i ulet 1/3 e dënimit duke u dënuar me 4 muaj burgim. Llogaritja e dënimit fillon nga data e arrestimit, por në referim të germës “c”, të pikës 1, të nenit 260, të Kodit të Procedurës Penale gjykata ka konstatuar shuarjen e masës së sigurimit “arrest me burg” për dy të pandehurit duke urdhëruar lirimimin e tyre.

8.1.1 Kundër këtij vendimi nuk është paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe ka marrë formë të prerë në datën 28.1.2019.

8.1.2 Nga verifikimi rezulton se për veprën penale “vjedhje” objekt gjykimi në nenin 134/1 të Kodit Penal parashikohet dënimi me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet, ndërsa për veprën penale “përvetësim të parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale” në nenin 287/b të Kodit Penal parashikohet dënim me burgim nga 6 muaj deri në 3 vjet. Prokurori, në pretendencën e tij, ka kërkuar minimumin e masës së dënimit me burgim.

8.1.3 Kjo çështje penale është proceduar me gjykim të shkurtuar, të cilën gjyqtarja e ka pranuar si të bazuar në ligj. Në referim të parashikimeve të pikës 2, të nenit 403, të Kodit të Procedurës Penale “vjedhja” dhe “përvetësim të parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale” përfshihen tek ato vepra për të cilat lejohet aplikimi i gjykimit të shkurtuar. Nëpërmjet aplikimit të gjykimit të shkurtuar shtetasit R. B. dhe R. I. kanë përfituruar uljen e 1/3 të masës së dënimit.

8.1.4 Subjekti i rivlerësimit shpjegon se në shqyrtimin e kësaj çështjeje dhe në marrjen e vendimit përfundimtar është bazuar në tërësinë e provave të administruara në gjykim në përputhje me parashikimet e ligjit procedural dhe material penal, si dhe në bindjen e brendshme të formuar nga të dhënat që rezultojnë nga vlerësimi objektiv dhe tërësor i provave dhe, për këtë, shprehet se: *“Në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit, duke iu referuar masave të dënimit të parashikuara nga nenet respektive të Kodit Penal (neni 134 dhe 287/b) kam analizuar dhe konsideruar kushtet dhe kriteret ligjore për përcaktimin dhe individualizimin e dënimit për secilin të pandehur në zbatim të nenit 47 të Kodit Penal, duke aplikuar uljen me 1/3 e masës së dënimit në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar”.*

8.2 Vendimi²⁶ nr. ***, datë 6.6.2019 (regjistruar më 12.7.2017) me palë të pandehur A. M., i akuzuar për veprat penale “vjedhje me dhunë në bashkëpunim” dhe “vjedhje me pasojë vdekjen”. Prokuroria ka kërkuar deklarinin fajtor të të pandehurit A. M. për akuzën “vjedhje me dhunë” dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim, si dhe deklarinin fajtor për veprën penale “vjedhje me pasojë vdekjen” dhe dënimin e tij me 17 vjet burgim. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal prokurori ka kërkuar bashkimin e dënimeve dhe dënimin e tij përfundimisht me 17 vjet burgim.

8.2.1 Kjo çështje është gjykuar në trup gjykues ku kryesues ka qenë gjyqtari D. H. dhe gjyqtarja Rudina Palloj ka qenë në cilësinë e anëtares. Trupi gjykues ka konkluduar në përfundim të gjykimit duke vendosur deklarinin fajtor të të pandehurit A. M. për veprën penale

²⁴Shihni shkresën nr. *** prot., datë 3.11.2021.

²⁵Prokuror T. P.

²⁶Shihni shkresën nr. *** prot., datë 3.11.2021.

“vjedhje me pasojë vdekjen” dhe dënimin e tij me 17 vjet burgim, si dhe ka vendosur deklaram të pafajshëm të të pandehurit A. M. për veprën penale “vjedhje me dhunë”.

8.2.2 Ky vendim është apeluar në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

8.2.3 Nga verifikimi rezulton se për veprën penale “vjedhje me pasojë vdekjen” objekt gjykimi neni 141/a i Kodit Penal parashikon dënimin me burgim nga 15 deri në 25 vjet ose me burgim të përjetshëm.

Për veprën penale “vjedhje me dhunë” trupi gjykues është shprehur se nuk rezulton që të jenë zhvilluar hetime dhe as të jetë ngritur akuzë, pasi nga ana e autoriteteve të drejtësisë greke gjykimi për këtë vepër penale është pezulluar për të pandehurin A. M..

8.2.4 Subjekti i rivlerësimit shpjegon se në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues ka mbajtur qëndrim për mospranimin e kërkesës së të pandehurit për procedim me gjykim të shkurtuar dhe ky vendim i ndërmjetëm i marrë me shumicë ka sjellë si pasojë procedimin me gjykim të zakonshëm. Subjekti i rivlerësimit shprehet se: *“Kjo vendimmarrje është bërë objekt shqyrtimi mbi bazën e ankimit bashkë me vendimin përfundimtar dhe është vlerësuar si një vendimmarrje e drejtë nga Gjykata e Apelit Vlorë, sikurse rezulton nga përmbajtja e vendimit nr. ***, datë 24.6.2021”*.

Subjekti i rivlerësimit sqaron se ka qenë kundër konkluzionit për deklaramin e pafajësisë së të pandehurit për veprën penale “vjedhje me dhunë” dhe këtë qëndrim e ka materializuar nëpërmjet arsyetimit të mendimit të pakicës që i është bashkëlidhur vendimit dhe, për këtë, shpjegon: *“Së pari, duke qenë para një fakti penal që nuk i ishte nënshtruar hetimit, pasi organi i akuzës nuk ka regjistruar asnjëherë procedim penal dhe nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, si dhe gjatë gjykimit nuk u kërkua marrja e asnjë prove apo akti nuk mund të konkludohet me pafajësi për këtë akuzë.*

Së dyti, marrja e një vendimi pafajësie në një rast të tillë do të përbënte pengesë thelbësore për regjistrimin e procedimit penal, hetimin dhe gjykimin e këtij shtetasi mbi ngjarjen e ndodhur nëse nga autoritetet greke do të bëhej në një moment të mëvonshëm transferimi i procedimit penal lidhur me këtë fakt apo edhe nëse do të kërkohet në të ardhmen njohja e vendimit penal të huaj të autoriteteve gjyqësore greke në eventualitetin e gjykimit dhe dënimit të këtij shtetasi nga gjykatat e huaja.

Së treti, referuar parashikimeve të nenit 4.1 të Protokollit 7 të KEDNJ-së dhe parashikimeve të pikës 2, të nenit 449, të Kodit të Procedurës Penale marrja e një vendimi pafajësie në këtë rast do ta bënte të pamundur rishikimin e vendimit përkatës në rast se do të hetohej më vonë apo do të gjendeshin prova që implikonin të pandehurin”.

8.2.5 Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si dokument vendimin nr. ***, datë 6.6.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, së bashku me mendimin e anëtarit në pakicë, si dhe vendimin nr. ***, datë 24.6.2021, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

8.2.6 Nga shqyrtimi i akteve rezulton se Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë për shpalljen fajtor dhe dënimin e të pandehurit me 17 vjet burgim. Por kjo gjykatë nuk është shprehur mbi vendimin e shumicës dhe të pakicës lidhur me shpalljen të pafajshëm të këtij të pandehuri për veprën penale “vjedhje me dhunë”. Subjekti i rivlerësimit shpjegon: *“Nga vendimi i Gjykatës së Apelit që ka shqyrtuar këtë çështje është disponuar për lënie në fuqi të vendimit, por nuk rezulton që të jetë vlerësuar i drejtë apo i gabuar as qëndrimi i shumicës për pafajësi dhe as qëndrimi im kundër këtij disponimi, pasi kjo çështje nuk është bërë objekti shqyrtimi në apel për shkak të mosankimimit nga palët”*.

8.3 Trupi gjykues, pas vlerësimit të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në raport edhe me dokumentacionin mbi denoncimet, nuk vërejti rrethanave për fakte që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore apo të dhëna dhe *indicie* për subjektin e rivlerësimit, të cilat duhet të mbahen në konsideratë në vlerësimin e saj profesional apo të figurës, gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të aftësive profesionale

30. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe konsiderohet “e aftë”.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas kërkesave të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në germën “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti i rivlerësimit Rudina Palloj ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë të vlerësimit të aftësive profesionale,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Rudina Palloj, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 17.1.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta TAFA (BUNGO)
Kryesuese

Valbona SANXHAKTARI
Relatore

Lulzim HAMITAJ
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj